

**AKT THEMELIMI  
DHE  
S T A T U T I  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
TIRANA IN TRADE SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më datën 12.09.2022 (dymijënjzetedy), ditë e hënë, unë, Mateo Dedja lindur më 26.04.1991 në Tiranë dhe banues në Tiranë me nr. Personal J10426062D; me zotësi të plotë juridike për të vepruar; mbështetur mbi të drejtën që na jep ligji nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kam vendosur të themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe nxjerrë këtë statut me kushtet si më poshtë.

Në këtë statut do të kuptohet se me - “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; - “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

Sot, më 12.09.2022 (dymijënjzetedy), unë ortaku e shoqërisë Mateo Dedja kam vendosur të themeloj këtë shoqëri tregtare të cilën do ta emërtoj “**TIRANA IN TRADE**” sh.p.k me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Themeluesi i shoqërisë:

- Mateo Dedja mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034514379 dhe me nr.personal J10426062D.

**Ortaku e harton këtë statut, si më poshtë vijon:**

**Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë**

Themelohet shoqëria me emrin "**Tirana In Trade**" Sh.p.k., Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij Akti Themelues dhe Statutit të shoqërisë të miratuar nga ortaku dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 2 Selia**

Selia e shoqërisë "**Tirana In Trade**" Sh.p.k., do të jete në adresën: Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, bulevardi “Bajram Curri”, Pallatet Agimi, Apartamenti 128, Tiranë  
Shoqëria, për nevoja të zhvillimit, mundet sipas diskrecionit të saj të hapë degë të tjera dytësore, zyra përfaqësimi dhe zyra administrative, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3 Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Shoqëria do të krijohet për një afat të pacaktuar.

Shoqëria e fiton personalitetin e vete nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 4 Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka për objekt: Import-eksport, prodhim e tregtim, me shumicë e pakicë të artikujve industrial, materialeve të ndërtimit, të paisjeve elektrike dhe elektronike, të makinerive të të gjitha llojeve, të paisjeve dhe impianteve të ndryshme të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregtar, etj. Shitje, tregtim, transport të materiale inerte, përfshirë dyer, dritare etj dhe gjithë materialeve të tjera.

Kryeje punimesh publike nëpërmjet prodhim, shitje, tregtim, furnizim dhe montim të tyre.

Zhvillim të projekteve në sektorin, ndërtim dhe mirëmbajtje e punimeve civile, objekteve të ndryshme.

Të kryejë çdo veprimtari tjetër për të mbështetur ndjekjen e qëllimeve institucionale.

Promovimi dhe pjesëmarrja në mundësi të ndryshme investimi që mund të paraqiten në çdo sektor të ekonomisë së vendit, duke u prezantuar si investitor i barabartë me subjekte të tretë, investitor i vetëm ose investitor mazhoritar me qëllim arritjen e objektivave ekonomike të shoqërisë dhe pjesëmarrjes në projektet me impakt social që diktojnë rritjen ekonomike të vendit dhe standartet e tij të jetesës.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

Shoqëria do të udhëhiqet gjithnjë, në ndjekje të objektivave të saj, mbi parimet e tolerancës, solidaritetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, dinjitetit njerëzor dhe forma të tjera të jetës, si dhe të mjedisit përreth.

Gjithashtu Shoqëria mund të përfitojë pjesëmarrje apo interesa në kompani apo shoqëri të tjera me objekt aktiviteti, të ngjashëm ose plotësues të Shoqërisë dhe që konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektit të Shoqërisë.

Shoqëria mund të kryej, në interesin e saj dhe të shoqërive dhe kompanisë në të cilat ka përfituar pjesëmarrje dhe interesa, të gjitha veprimet tregtare dhe financiare, si të luajtshëm dhe të paluajtshëm, të cilat konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përfshirë këtu dhënien e garancive, atyre personale dhe garancive të tjera reale.

Aktivitete të tjera: Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të bashkëpunojë me persona fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj, duke pasur të drejtën për të hapur degë apo zyra përfaqësimi edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 5. Kapitali i Shoqërisë**

- 5.1 Kapitali i shoqërisë “Tirana In Trade” Sh.p.k. do të jetë 10000.00(dhjetëmijë) Lekë . Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (një) kuotë:  
1 (një) kuotë e barabarte me 100% e kapitalit të zotëruar nga Mateo Dedja;  
Kapitali fillestar i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet dhe është totalisht i likuidueshem dhe i nënshkrueshem.
- 5.2. Kapitali i shoqërisë përbehet nga kapitali fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepet të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.
- 5.3 Kuotat e kapitalit derdhen nga ortaket në Banke, në llogarinë bankare të shoqërisë.
- 5.4 Të gjitha pjeset e kapitalit themeltar janë të nënshkruara nga ortaket e shoqërisë.

#### **Neni 6 Transferimi i kuotave me akt midis të gjallëve dhe me trashëgimi**

- 6.1 Transferimi i kuotave është i vlefshëm si me akt midis të gjallëve si dhe me trashëgimi ndaj ortakeve të shoqërisë, vetëm në rast se rezultojnë se janë respektuar dispozitat e këtij neni.
- 6.2 Në rast transferimi me akt midis të gjallëve të kuotave, ortakeve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues me pare duhet të bëjë një ofertë, ortakeve të tjera me rekomandë, ku përcakton çmimin e kërkuar për shitjen e kuotave të tij. Në këtë rast secili nga ortaket në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin themeltar ka të drejtën e parablerjes.
- 6.3 Në rast mosmarrëveshjeje mbi çmimin e kërkuar, me kërkesë të çdo njëres prej paleve të interesuara, do të caktohet një ekspert kontabël, me miratim nga asambleja e përgjithshme e ortakeve me shumicë të thjeshtë, i cili do të caktojë çmimin e shitjes, duke u bazuar mbi vlerën reale të kuotave.
- 6.4 Në rast mosmarrëveshjeje mbi emelimin e ekspertit kontabël, ky i fundit do të zgjidhet nga gjykata ku ka selinë shoqëria dhe me kërkesë të palës së interesuar.
- 6.5 Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe menyrave të parashikuara nga legjislati shqiptar.
- 6.6 Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, shitesi por edhe blerësi kanë të drejtë të tërhiqen, perkatesisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të personit që tërhiqet.
- 6.7 E drejta e parablerjes që nuk është ushtruar nga ana e njerit prej ortakeve i kalon ortakeve të tjera, gjithmonë në përputhje me pjeset e tyre në kapitalin themeltar.
- 6.8 Ortaku shites i kuotave duhet të transferojë keto të fundit me akt të shkruar ortakeve blerës brenda 3 (tre) muajve nga marrja e komunikimit sipas nenit 6.2 dhe në rast të vlerësimit të bere nga eksperti kontabël brenda afatit të 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e vlerësimit.

6.9 E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet brenda nje periudhe tre mujore nga data e komunikimit te ofertes ose brenda 60 diteve nga data e fiksimit te çmimit nga ana e ekspertit kontabël qe eshte emeruar. Pasi kane kaluar afatet e mesiperme dhe asnjë nga ortaket e tjere nuk ka shfaqur te drejten e parablerjes, shitesi ka te drejten te transferoje tek te tretet kuotat e tij.

6.10 Transerimi i kuotave, përkundrejt një subjekti që nuk eshte ortak apo jashtë shoqërisë, me anë te shitjes dhe/ose dhurimit mund te behet pa respektuar rregullat dhe procedurat e parashikuara në kete nen kur për kete veprim asambleja e ortakëve merr vendim unanim per shitjen/dhurimin e aksioneve nje personi te trete. Asambleja e ortakëve me vendi lejon shitjen/dhurimin dhe ose transferimin e kuotave.

6.11 Transferimi i kuotave per shkak trashëgimie ndaj trashigimtarve te te ndjerit eshte i kufizuar nga konsensi i te gjithë ortakëve te mbledhur ne asamblene e përgjithshme. Ne rast kundërshtimi te ortakëve per transferimin e kuotave drejt trashigimtarve te te ndjerit, çmimi i shitjes do te caktohet sipas procedurave per transferimin me akt midis te gjalleve si me siper.

#### **Neni 7**

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakëve te saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe modalitetet.

#### **Neni 8**

Shoqëria tregtare Tirana In Trade Sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj te akumuluar. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurisë se vet te akumuluar, tek te tjerët. Ne Republikën e Shqipërisë, Tirana In Trade Sh.p.k. gëzon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

#### **Neni 9**

Shoqëria Tirana In Trade Sh.p.k., vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

#### **Neni 10 Drejtimi i Shoqërisë**

Bëjnë pjese ne detyrat dhe kompetencat e ortakëve, te mbledhur ne asamble te përgjithshme, te gjitha ato qe janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe te listuar ne këtë statut. Nder këto detyra përfshihen:

ndryshimi ne aktin e themelimit dhe ne statut;

miratimi i veprimtarisë se administrimit, te inventarit, te bilancit te llogarisë vjetore;

emërimi e shkarkimi i administratoreve ortake e jo-ortake dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave te tyre, duke përcaktuar se qofte për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do te jete e domosdoshme te jepet shprehimisht një shkak;

miratimin e kredive dhe te garancive;

miratimi i tarifave për shërbimet qe kryen shoqëria;

përcaktimi i formës se vulës dhe te markës se shoqërisë;

zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit te shoqërisë;

mbikëqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë;

miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë;

vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, zyrave te përfaqësimit ose te agjencive te shoqërisë;

vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e shoqërisë;

vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore ne te cilën është e përfshire shoqëria, duke autorizuar kështu administratorin e vetëm;

vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar apo te konsulentëve te tjerë, qofte persona fizike apo juridike;

vendimin për ndarjen e kotave dhe për anulimin tyre;

vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave te procedurës për mbledhjen e asamblesë;

vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;  
vendimin në transferimin e kuotave të shoqërisë;  
vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;  
marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.  
Përgjatë gjithë periudhës së ciles shoqëria do të kontrollohet nga ortakët e shoqërisë, vendimet e tyre do të regjistrohen në regjistrin përkatës, sipas parashikimeve ligjore.

### **Neni 11**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me një nga këto mënyra: njoftim elektronik email dhe/ose apo mesazh telefonik, shkresë formale ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike. Përdorimi i njerës nga mënyrat e njoftimit është i mjaftueshëm për tu konsideruar njoftim zyrtar. Përdorimi i njeri njoftim përjashtin mënyrat e tjera. Adresat e ortakëve, numrat e telefonit dhe ardesa e postës elektronike të ortakëve do të regjistrohen në një bazë të dhënash të dokumenteve të shoqërisë.  
Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.  
Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

### **Neni 12**

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja apo votimi në asamble të përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike.  
Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.  
Asambleja e përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet t'i nënshtrohen dispozitave të këtij statuti për sa i përket kuorumit dhe shumicës së nevojshme për marrjen e vendimeve.  
Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamble është pjesëmarrja e shumicës së ortakëve që me pas vendosin me të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë) të votave të ortakëve të pranishëm, përveç rasteve kur ligji parashikon një shumicë më të ulët.

### **Neni 13**

#### **Administratori**

Shoqëria do të drejtohet nga një administrator i vetëm.  
Administratori statutor i Shoqërisë do të jetë z. Mateo Dedja.  
Mandati i administratorit ka një afat 4 vjeçar me të drejtë dipertëritje pa kufizim.  
Mandati i administratorit do të fillojë sot me datë 12.09.2022 dhe do të zgjasë deri më datë 11.09.2026.  
Administratori mund të shkarkohet përpara mbarimit të mandatit me vendim unanim të asamblesë së ortakëve.  
Administratori i shoqërisë administron shoqërinë që prej datës së themelimit të saj, me efekt ndaj të tretëve që prej regjistrimit në Regjistrin tregtar që mbahet nga QKB.  
Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për shkarkimin e tij përpara mbarimit të periudhës së emërimit.  
Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, sipas procedurave të parashikuara me ligj, por ka detyrimin e qëndrimit në detyrë deri në emerimin e një tjetër administratori.  
Qëndrimi në detyrë pas dorëheqjes nuk mund të jete më i gjatë se 1 muaj.  
Asambleja e përgjithshme mund të emërojë edhe me shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie dhe të jashtëm për shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në fuqi,

secili nga administratoret mund te ushtroje te gjitha tagrat e perfaqesimit dhe te firmes, persa i perket kompetencave te veta, te percaktuara paraprakisht nga asamblea e pergjithshme, regjistruar prane QKB. Secili nga ato do te jete individualisht pergjegjës per permbushjen e funksioneve te dhëna nga ligji per administratorin dhe do ti komunikojë te tjereve ose administratorit tjetër veprimet nga ai te kryera. Administratori ose administratoret kane detyrimin te raportojnë mbi veprimtarine e tyre perpara asamblese se pergjithshme, sa here kërkohet nga ortaku/ortaket.

#### **Neni 14**

Administratori kryen detyrat e percaktuara nga ortaket e shoqërisë ne këtë statut dhe te gjitha ato detyra te parashikuara dhe te rregulluara me ligj. Nder këto përshihen detyrat e listuara me poshtë.

Te veproje dhe te nënshkruaje ne emër te shoqërisë;

Te marre vendime lidhur me kreditë qe do te merren dhe dhënien e garancive, pas miratimit nga asambleja e pergjithshme;

Te përpunoje dhe te paraqesë për miratim ne asamblenë e pergjithshme raporte për ecurinë e aktivitetit te shoqërisë dhe te bilancit te mbylljes se aktivitetit financiar te vitit paraardhës, sipas asaj qe parashikohet ne ligj;

Te mbaje ne rregull regjistrin e vendimeve te asamblesë se pergjithshme;

Administratori është pergjegjës kundrejt shoqërisë dhe te treteve për shkeljet e ligjit apo te normave te statutit qe mund te ndodhin gjate ecurisë se aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar;

Te kryeje te gjitha aktivitetet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;

Te përfaqësoje shoqërinë tregtare;

Te kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë me korrektësi dhe saktësi;

Te kryeje regjistrimet dhe te dërgoj te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit;

Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut;

Te raportojë perpara asamblesë se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;

Te emeruje ekonomiste dhe konsulentë ligjore, tregtar, fiskal për probleme qe lidhen me shoqërinë, pas miratimit nga asambleja e pergjithshme. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer te shoqërisë;

Te mire-administroje shoqërinë;

Te lidhe marrëveshje me te trete ne kufijtë e objektit te aktivitetit te shoqërisë dhe te kompetencave te percaktuara nga ortaket;

Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqërisë;

Te jete pergjegjës për demet e shkaktuara shoqërisë nga veprimet e tij;

Te shpërblehet për punën qe kryen sipas marrëveshjes me ortaket themelues, ne baze te nje kontrate te përpiluar me shkrim;

Te prezantoje iniciativa dhe te beje propozime për çfarëdolloj gjeje qe e vlerëson si te rëndësishme për shoqërinë;

Te kryeje te gjitha veprimet bankare ne lidhje me llogarinë e shoqërisë brenda tagrave te dhëna nga asambleja e ortakeve;

Administratorja ka te drejte dhe detyre te thërrasë asamblenë e pergjithshme, sipas dispozitave te percaktuara ne nenet 12 dhe 13 te këtij statuti dhe te ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht ne statut.

#### **Neni 15 Te drejtat dhe detyrat e shoqërisë**

Shoqëria ka te drejte:

te kryeje veprimtari ne përputhje me objektin e veprimtarisë te shoqërisë;

te marre kredi ne leke dhe ne valute te huaje nga Bankat vendase ose te huaja ne baze te rregullave ligjore;

te përfitojë nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera;

te punësoje punëtore, vendas ose te huaj;  
te eksportoje lirisht fitimet dhe disidentet qe ka realizuar nga veprimtaria e saj.

#### **Neni 16**

Shoqëria ka për detyre:  
te siguroje kapitalin e shoqërisë ne formën dhe kohën e duhur;  
te japë garanci për shërbimet qe kryen shoqëria;  
te siguroje punonjësit e saj;  
te plotësoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj punemarresve te saj dhe paleve te treta;  
te pajiset me leje/autorizime te mundshme, nese kerkohen nga ligji, per te zbatuar objektin e veprimtarise se saj;  
te respektoje standardet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarinë e saj.

#### **Neni 17 Marrëdhëniet ekonomike – financiare te shoqërisë**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit te veprimtarisë se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik dhe librat kontabël te saj.

#### **Neni 18**

Ne selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te cilit, brenda datës 31 mars te çdo viti nxirret bilanci.

#### **Neni 19**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te te njejtit vit.

#### **Neni 20**

Shoqëria hap nje ose me shume llogari ne Banke. Llogarite mund te mbahen ne leke ose valute te huaj dhe pasqyrohen ne librat kontabël përkatës te shoqërisë.

#### **Neni 21 Dispozita te veçanta**

Shoqëria ka vulen e saj me përmasa te zakonshme, te realizuar sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi dhe mund te kete nje marke te veten.

#### **Neni 22 Shndërrimi**

Shndërrimi i shoqërisë Tirana In Trade Sh.p.k. ne shoqëri te tipeve te tjera, mund te behet me vendim te ortakeve themelues sipas menyrave te parashikuara ne ligj.

#### **Neni 23 Prishja e shoqërisë**

Shpërbërja e shoqërisë, mund te vije për shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe per arsyet si me poshte:  
kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;  
me vendim të asamblesë së përgjithshme;  
me hapjen e procedurave të falimentimit;  
nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të Art.t 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;  
me vendim të gjykatës;  
humbja e kapitalit te shoqërisë;  
Ne këto raste, ortaket e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shume likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se shoqërisë deri sa ajo t’u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqëria ndaj personave te trete.

#### **Neni 24 Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni**

Për te gjitha konfliktet qe mund te lindin midis ortakeve, ortakeve dhe Shoqerise dhe Shoqerise dhe administratoreve do te jete kompetent juridiksioni i gjykatave te Republikës se Shqipërisë, me zbatimin e ligjeve shqiptare.

**Neni 25**

Ky statut përpilohet ne 2 (dy) ekzemplare ne gjuhen shqipe, te nënshkruara rregullisht nga Ortaku i shoqerise.

*ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË*  
"Tirana In Trade" SH.P.K.

Mateo Dedja